

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

29.07.2024

Ora 11:06

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Lealba PELINKU Nënkomisionere Shtetërore e Zgjedhjeve

• Komisioni Rregullator:

Illirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• Lealba PELINKU Zv. KSHZ

• Stafi KQZ Znj. M. Koja, znj. D. Alimemeti.

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme, në orën 11.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, e pranishme është Nënkomisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve dhe zyrtarë të administratës. Nga shoqëria civile nuk kemi kemi, nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

partitë politike jo. Në rendin e ditës të mbledhjes... A kemi nga shoqëria civile një përfaqësues, nga organizata KRIIK. Në rendin e ditës së mbledhjes kemi një projektakt për të shqyrtuar. Projektakti, projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, do të pyesja kolegët nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës për të diskutuar, kolegë? Po, po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Po...

Znj. H. Vukaj: Do ta diskutojmë pasi të bëjmë prezantimin.

Znj. I. Nano: Pra, kemi çështje jashtë rendit të ditës edhe i diskutojmë në fund...

Z. M. Çakaj: Po.

Znj. I. Nano: ...pas shqyrtimit të projektaktit.


Z. M. Çakaj: Po, dakord.

Znj. I. Nano: Dakord, faleminderit!

Znj. H. Vukaj: Në fakt, vlen përpara se... Përpara votimit tonë, në lidhje me aktin, do të ishte më logjike për shkak të tematikës që do ngremë.

Znj. I. Nano: Dakord! Doni ta merrni tani fjalën apo gjatë shqyrtimit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Unë mendoj të bëhet prezantimi i aktit dhe pas prezantimit të aktit, pasi të kalojmë në vlerësim apo në votim. Unë do të doja të merrja fjalën, të ngrija disa pyetje për zonjën Pelinku.

Znj. I. Nano: Dakord, faleminderit! Atëherë fillojmë me një prezantim të shkurtër të projektvendimit dhe relacionit. Zonja Koja, po faleminderit!

Znj. M. Koja: Po, faleminderit! Përshëndetje të nderuar anëtarë! Atëherë në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr.10019, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet përgjegjësia e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejtimit të punës për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Në zbatim të kësaj dispozite, Nënkomisioneri bashkëushton me të drejta të barabarta me Komisionerin, kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve. Në zbatim të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose anëtarët e tij, për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre. Si dhe në zbatim të nenit 22, pika 4, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet kompetenca e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje është hartuar ky projektvendim. Në zbatim të sa relatuar më lart, në këtë projektvendim parashikohet përdorimi i pajisjeve elektronike të identifikimit PEI në të gjitha qendrat e votimit, për të kryer identifikimin elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024. Ngarkohet me përgjegjësi për zbatimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

këtij projektvendimi administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte, për sa më sipër relatuar, Komisioneri dhe Nënkomisioneri, nëpërmjet administratës i propozojnë Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Koja! Fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Zonja Vukaj dëshironi ta merrni tani fjalën? Faleminderit!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit për fjalën! Të nderuar pjesëmarrës, të nderuar qytetarë! Në narracionin se çfarë përbën ky akt, do të thosha që ky është në vazhden e akteve të cilët mundësojnë realizimin e një procesi të garantuar. Është një akt i cili merr përsipër të identifikojë në formatin elektronik votuesit. Përpara se të kalojmë tek shqyrtimi i këtij akti, unë së pari, vlerësoj prezencën e zonjës Nënkomisionere në këtë sallë dhe faktin që ajo ka zgjedhur të jetë prezent për këtë akt tregon seriozitetin me të cilin shihet implementimi i këtij procesi, pra implementimi i pajisjes së identifikimit elektronik. Zonja Pelinku, në dijeninë tonë, administrata na serviri faktin që raporti teknikien i auditimit është dorëzuar. Pra, raporti teknikien i auditimit mbi listat që ka gjeneruar Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për këto zgjedhje është audituar dhe është vlerësuar. A jeni njohur dhe vlerësuar, e keni vlerësuar këtë raport teknikien të auditimit? Nëse po, cilat janë shifrat apo të dhënat, të cilat për ju janë sensitive në kushtet e implementimit po aq sa edhe për sigurinë e këtyre zgjedhjeve? Nga ana tjetër, nëse ka shifra sensitive do të doja një vlerësim tuajin në raport me... nëse ju i shikoni vërtet në raport alarmant, krahasuar me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

zgjedhjet e vitit 2023. Mund të vijoj më tej pasi të marr këto përgjigje, me pyetje të tjera. Faleminderit!

Znj. L. Pelinku: Faleminderit! Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, lidhur me pyetjen e zonjës Vukaj, raporti i auditit teknikien është paraqitur, është publikuar dhe në faqen e KQZ-së, është i aksesueshëm për të gjithë. Nisur nga dispozitat e Kodit, dhe konkretisht tagrat që ka Komisioneri dhe Nënkomisioneri lidhur me gjetjet që ..., gjetje të cilat rezultojnë nga ky raport, personalisht, në fakt, në cilësinë e Nënkomisionerit, ajo çfarë kam vënë re dhe për të cilën do të ushtroj po sërish në bazë të pikës 8, të nenit 61, kompetencën për të kërkuar shpjegime pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Gjendjes Civile, lidhur me vlerat apo si të thuash gjetjet në raport me krahasimin, zgjedhës në listën zgjedhore të 2023. Lista përfundimtare ka qenë e 4 prillit 2023 dhe ajo e 10 korrikut 2024, pra lidhur me listën e Bashkisë Himarë për zgjedhjet në proces. Ajo që bie në sy është që kemi një... në fakt është edhe gjetje e auditit teknikien, ajo që bie në sy është fakti që nëse do të krahasojmë ndryshimin e numrit të zgjedhësve nga 2021 në 2023, pra harku kohor i dy viteve rezulton që ka një ulje në vlerë absolute të 8 zgjedhësve. Ndërkohë që nga 4 prilli 2023 lista përfundimtare e zgjedhjeve për 14 majin, në 10 korrik 2024 për zgjedhjet në proces, rezulton që ka një rritje 252 në vlerë absolute. Por, ajo që bie në sy është numri 311 i zgjedhësve të cilëve ju është ndryshuar vendbanimi, pra nga bashki të tjera janë regjistruar në Bashkinë Himarë. Nisur nga kjo, si të thuash, gjetje e cila, domethënë kemi të bëjmë me një ndryshim vlerash në vlerësimin tim anormal, nga minus 8 në 252 apo 311 që janë votues me vendbanim të ri në Himarë. Jemi në fazën e të drejtuarit me shkresë te Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për të pasur një informacion më konkret, lidhur me datat kur janë realizuar, apo kur është miratuar kërkesa e këtyre zgjedhësve për t'ju ndryshuar vendbanimin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Faleminderit! Viojmë me pyetjen tjetër. Kjo shifër prej 311 votues të shtuar në listën për këto zgjedhje... A keni kërkuar ju informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, që në cilat rrethana janë regjistruar një masë e shtuar, papritmas, në këto zgjedhje kaq të befta dhe a janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore, formale për secilin zgjedhës? Pra, dokumentacioni i kërkuar dhe kriteret që përcakton ligji për t'u bërë banor i një bashkie tjetër? A keni kërkuar informacion deri tani?

Znj. L. Pelinku: Siç e thashë dhe më përpara, raporti i auditit teknikien është paraqitur para tre-katër ditësh dhe jemi në fazën e dërgimit të shkresës, pra hartimit të shkresës. Pasi si të thuash të konkludojmë lidhur me të gjitha gjetjet nga të cilat burojnë, buron edhe nevoja për shpjegime. Kështu që kjo do të jetë eventulisht një pyetje. Unë shpresoj që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të respektojë detyrimin, në radhë të parë, të respektojë detyrimin për ta dhënë këtë informacion. E ka detyrim për t'i dhënë shpjegime Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, detyrim të cilin në fakt në zgjedhjet e 14 majit, po për të njëjtën... raport që ka KQZ-ja me këtë institucion, përse i takon listës së zgjedhësve, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur, e ka shpërfillur kërkesën për shpjegime. Shpresoj që të kem një informacion për sa do t'i kërkojmë dhe në varësi të informacionit që do të sjellë mund të jetë një kërkesë tjetër ajo çfarë ju referoni.

Znj. H. Vukaj: Një pyetje tjetër. Në dijeninë tuaj sa zgjedhës apo votues kanë të njëjtin kod vendbanimi dhe siç ne rëndom kemi hasur këtu, fenomenin e krijuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, janë të zhvendosur në qendra të ndryshme të votimit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

Znj. L. Pelinku: Ajo që rezulton nga gjetjet e auditit teknikien, për sa ka të bëjë me këtë pyetje, e cila në fakt do të jetë objekt i kërkesave për shpjegim që do të jenë pjesë e shkresës me të cilën do t'i drejtohem DPGJC-së. Kemi të bëjmë me një rritje përsëri, në raport me 2023. Kemi 157 raste ku pjesëtarë të të njëjtit trung familjar rezultojnë në qendra votimi të ndryshme, kur ndërkohë rregulli është që duhet të rezultojnë në të njëjtën qendër votimi. Pak a shumë rastet për këtë kategori kanë qenë rreth 50 në 2023, kështu që parë kjo rritje, në pamje të parë anormale edhe kjo do të jetë pjesë e shpjegimeve.

Znj. H. Vukaj: Edhe njëherë, ju po theksoni recidivizmin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Ndaj natyrshëm më lind pyetja se cilat janë masat apo iniciativat që ka marrë, në kushtet e ligjzbatimit ose drejt organeve ligjzbatuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pra në dijeninë tuaj gjithmonë?

Znj. L. Pelinku: Nga ajo çfarë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka tagër në raport me DPGJC-në është që t'i kërkojë shpjegime dhe më pas në raport me... Në varësi të asaj çfarë do të rezultojë nga shpjegimet që shpresojmë të vijnë nga DPGJC-ja, legjislacioni është i qartë.

Znj. H. Vukaj: A keni menduar ndonjëherë t'i drejtoheni Kontrollit të Lartë të Shtetit për një auditim tematik duke pasur këtë si indicie apo auditim performance për këtë rast sepse është shumë e rëndë që në çdo zgjedhje të ndodhin të njëjtat fenomene. Unë do të sugjeroja që ju të rinisnit duke përdorur këtë për indicie, një kërkesë drejt Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili në këtë mbledhje publike... Pra është fakt tashmë, që njihet publikisht, raporti është i publikuar mund të nisni dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

kryesisht. Por, detyra lind që këtu, sepse jemi ne organi i cili mban përgjegjësi për zgjedhje dhe vota apo votime të lira, të ndershme, të pandikuara, të pamanipuluara, të patjetërsuara.

Znj. L. Pelinku: Në fakt, për sa përcakton Kodi Zgjedhor, roli i Nënkomisionerit është i qartë. Pra, në raport me listat e zgjedhësve, si të thuash raportin e ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe mbi bazën e këtij raporti të vijojnë edhe hapat e tjerë që mund të ndërmerren Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Besoj që kjo është një kërkesë, e cila mund t'i drejtohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si organ i cili mban raportet me organet e treta.


Znj. H. Vukaj: Gjej rastin këtu që administratës t'i lë detyrë që këtë indicia dhe një kopje të raportit t'ia përcjellë Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka detyrën dhe detyrimin kryesisht të fillojë vlerësimin e një auditimi të posaçëm tematik apo performance në lidhje me këtë drejtim. Pasi shifra 311 votues e shtuar, në kushte të pashpjegueshme, është apriori, të bën të mendosh se ka diçka që nuk shkon në raport me veprimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Apo 157 personave të cilët i është tjetërsuar, apo zhvendosur qendra e banimit duke pasur të njëjtin kod vendbanimi. Faleminderit zonja Pelinku mund të vazhdojmë me procesin.

Z. M. Çakaj: Më fal, kam unë diçka.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj, po.

Z. M. Çakaj: Atëherë, paraprakisht, kisha një pyetje për zonjën Pelinku. Së pari e falenderoj që ka marrë pjesë dhe ka prezantuar vetë këtë projektakt shumë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

rëndësishëm, i cili përbën një garanci të shtuar për gjithë palët që marrin pjesë në zgjedhje, si dhe përbën një garanci të shtuar edhe për ne si Komision Qendror Zgjedhjesh, për të garantuar një proces identifikimi të drejtë, të rregullt dhe të barabartë me të gjithë palët. Së dyti, kisha një pyetje teknike. Zgjedhësi i cili paraqitet në qendrën e votimit, në bazë të Kodit Zgjedhor, por dhe në bazë të akteve nënligjore të miratuara nga ky Komision Rregullator duhet të ketë me vete ose pasaportë, të vlefshme ose kartë identiteti të vlefshme, apo jo? Një zgjedhës i cili disponon pasaportë ose kartë identiteti, në rastin konkret, por të cilit i ka skaduar në datë, një ditë para zgjedhjeve vlefshmëria a mund të identifikohet në mënyrë biometrike nga pajisja elektronike e identifikimit?

Znj. L. Pelinku: Po, pajisja e mundëson identifikimin dhe evidentohet edhe fakti që dokumenti me të cilin identifikohet, qoftë karta e identiteti qoftë pasaporta biometrike është jashtë afatit të vlefshmërisë.

Z. M. Çakaj: Po si, në eksperiencën tuaj, marr shkas këtu nga të gjithë... Ka qenë një praktikë e mire e qeverisë shqiptare e cila në zgjedhjet pararendëse, marr shembull zgjedhjet e vitit 2021, zgjedhjet e përgjithshme, ka miratuar një vendim të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit ka zgjatuar afatin e vlefshmërisë të kartave të identitetit, në mos gaboj me pesë ditë. Në këto kushte që të... Në që t'i garantojë dhe atyre shtetasve të cilët u ka qëlluar fati t'u mbarojë vlefshmëria e kartës së identitetit, e afatit të kartës së identitetit, në datën 3 apo 2, apo dhe 4 gusht. Gjej rastin që administrata t'i drejtohet Ministrisë së Brendshme, ose bëj dhe një thirrje publike këtu, do të jetë në nderin e qeverisë që të miratojë një vendim të Këshillit të Ministrave për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë, qoftë dhe me dy-tre ditë për të gjithë shtetasit me banim, zgjedhësit, shtetasit shqiptarë me banim në Himarë, të cilëve u

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

skadon afati i vlefshmërisë së kartës së identitetit, në datën 2 apo 3 gusht. Unë e vlerësoj të rëndësishme për procesin dhe besoj se do të ketë një vesh ta dëgjojë nga qeveria thirrjen time. Nga ana tjetër lidhur me gjithë relatimin tuaj dhe pyetjet e shtruara, qoftë në seancë, në mbledhjen e kaluar, qoftë në këtë mbledhje, besoj se tashmë është e qartë një panoramë... Pra, ka një tërësi faktorësh, të cilët, duke filluar që nga data e shpalljes befas të zgjedhjeve, që nga vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që nga mosrespektimi i afatit të ankimimit, si një e drejtë kushtetuese e zotit Beleri, që nga dekreti i Presidentit e të tjera me radhë. Ka një tërësi faktorësh, të cilët po shkojnë drejt një procesi, që është shumë i mbushur me të panjohura ndoshta dhe parregullsi. Në këto kushte nuk do të doja që të zhgënjeheshim dhe t'i jepnim shqiptarëve një rezultat zgjedhor të paqartë, të paqenë, të manipuluar. Kështu që unë ftoj të gjithë aktorët, gjithë palët, gjithë politikën, mazhorancë, opozitë, të cilët të tregohen të përgjegjshëm dhe t'i lënë shqiptarët të votojnë në mënyrë të lirë, të drejtë dhe të barabartë. Himara meriton të ketë një kryetar bashkie, i zgjedhur me votat e qytetarëve apo gjithë komunitetit të Bashkisë Himarë, kështu që shpresoj që thirrja ime të dëgjohet. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Atëherë meqë jemi në diskutimin në parim të projektvendimit “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve...”, unë kisha vetëm një pyetje, nuk e di zonja Pelinku ose zonja Alimemeti, nëse është bërë testimi i pajisjeve?

Znj. L. Pelinku: Është parashikuar për t'u kryer, ngelet për t'u konfirmuar zyrtarisht, por të mërkurën, pra pasnesër.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

Znj. I. Nano: Dakord. Pasi të bëhet testimi i pajisjesve do t'ju lutesha një informacion. Ne sot po shqyrtojmë dhe uroj që të miratojmë këtë akt, që ky akt të mos mbetet i pazbatueshëm, një informacion pas testimit të pajisjeve për situatën, me email, nëse është e mundur. Faleminderit! Kolegë, diçka tjetër në parim? Nga shoqëria civile ka diçka në parim për projektvendimin? Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka.

Miratohet me 5 vota pro.

Kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë. Atëherë me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit PEI, në të gjitha qendrat e votimit, në Bashkinë Himarë.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka.


Miratohet me 5 vota pro. Pika dy:

Pika 2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 29.07.2024*

Kundër: s'ka.

Miratohet me 5 vota pro.

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka.

Miratohet me 5 vota.

Pika 4. Kundër këtij vendimin mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka.

Miratohet! E votojmë dhe në tërësi projektvendimin pasi e kemi votuar në parim dhe nen për nen dhe njëherë kolegë ju lutem!

Kush është dakord në tërësi?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka.

Miratohet me 5 vota pro.

Në rendin e ditës siç u njoftua në fillim të mbledhjes kishim vetëm këtë çështje, jashtë rendit të ditës zoti Çakaj kishit diçka?

Z. M. Çakaj: Jo.

Znj. I. Nano: Apo është ajo që e ezauruat? Meqënëse nuk kemi çështje të tjera mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 06

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

